



REPUBLIKA E SHQIPERISE



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE



MIRATOHET

DEKANI

Prof. Dr. Shkëlqim KUKA

RREGULLORE

e

PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË

DOKTORATË

në

INXHINIERI MATEMATIKE

TIRANË, 2022



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE

I. Të përgjithshme

Neni 1

Kjo rregullore është hartuar nga Departamenti i Inxhinierisë Matematike të Universitetit Politeknik të Tiranës. Ajo mbështetet në, Ligjin Nr 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 për “Elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 për “Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.1.2018”, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”.

Programi i ciklit të tretë të studimeve të *Doktoratës* në “*Inxhinieri Matematike*”, është hapur me Urdhër të MASH, Nr. 605, date 29. 12. 2010 dhe riorganizuar në bazë të ligjit Nr 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të sipërpërmendura.

Programi i studimit i ciklit të tretë, *Doktoratë* në “*Inxhinieri Matematike*”, zhvillohet referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Ky program studimi i ciklit të tretë ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Matematike, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Universiteti Politeknik i Tiranës.

Neni 2

Programi i studimit i ciklit të tretë, *Doktoratë* në “*Inxhinieri Matematike*”, ka për qëllim paisjen e studentëve me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer kërkime shkencore me nivel të lartë pranë universiteteve, trupave publike, dhe organizatave private; duke zhvilluar më tej progresin shkencorë dhe teknologjik si dhe krijimin e një klase udhëheqëse profesionistësh me nivel të lartë njohurish, të aftë të bashkëpunojnë në nivele ndërkombëtare.

Neni 3

Programi i studimeve *Doktoratë* në “*Inxhinieri Matematike*”, është një program studimi i ciklit të tretë i hapur pranë Departamenti të Inxhinierisë Matematike, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, UPT.



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE

Neni 4

Programi i studimit *Doktoratë* në “*Inxhinieri Matematike*”, zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe në bashkëpunim me institucione të tjera vendase dhe/ose të huaja, publike dhe/ose private kur është e nevojshme.

II. ORGANIZIMI

Neni 5

Programi i studimit *Doktoratë* në “*Inxhinieri Matematike*”, realizohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, 2019, Rregulloren e brendshme të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike dhe drejtohet nga Departamenti i Inxhinierisë Matematike si njësi bazë e këtij fakulteti dhe si sektori përkatës i ekspertizës në UPT për këtë fushë.

Studimet e doktoratës, zhvillohen me kohë të plotë pranë DIM ose me kohë të zgjatur në ato raste, kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.

1. Studimet e doktoratës, organizohen brenda një projekti kërkimor-shkencor e zhvillimor dhe realizohen në koordinim me veprimtari të kërkimit të grupeve kërkimore brenda DIM dhe miratim nga Këshilli i Profesorëve i FIMIF.
2. Kur studimet e doktoratës, zhvillohen në bashkëpunim midis UPT-së dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese.
3. Studimet e doktoratës, mund të përmbajnë veprimtari të formimit të thelluar teorik, bazuar në rekomandimet përkatëse të drejtuesit shkencor të doktoratës, për të përvetësuar metodologjitë bashkëkohore të kërkimit, aplikimit etj.
4. Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga DIM dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti është në varësi të projekteve kërkimore brenda DIM.
5. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë. Ky numër përfshin udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë “Profesor” ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku ai është i angazhuar.
6. Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës, zhvillohen në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, SHBA-ve dhe Kanada, bashkëudhëheqësi shkencor në këto vende pritëse, mund të jetë edhe me gradën “Doktor”.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE

Neni 6

Detyrimet e Departamentit të Inxhinierisë Matematike:

- Paraqitja e programit të studimit për miratim në Senatin e UPT
- Përgatitja e planit mësimor
- Rishikimi i programeve mësimore
- Hartimi i strukturës mësimore
- Menaxhimi i të gjithë aktiviteteve mbështetëse për mbarëvajtjen e programit të studimit

Neni 7

Programi i studimit i ciklit të tretë *Doktoratë* në “*Inxhinieri Matematike*”, organizohet pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, si dhe pranë laboratorëve të Departamentit të Inxhinierisë Matematike dhe në bashkëpunim me institucione të tjera vendase dhe/ose të huaja, publike dhe/ose private kur është e nevojshme.

Neni 8

Programi i studimit i ciklit të tretë *Doktoratë* në “*Inxhinieri Matematike*”, kryen të gjitha regjistrimet e veta nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të FIMIF.

III. Pranimi dhe përzgjedhja e kandidatëve

Neni 9

Në Programin e Studimit të ciklit të tretë *Doktoratë* në “*Inxhinieri Matematike*”, Pranohen kandidatët që kanë:

- a. Diplomë universitare “Master i Shkencave” në Inxhinieri Matematike, (ose ekuivalente me të sipas akteve ligjore dhe nënljore në fuqi).
- b. Diplomë e sistemit të vjetër 5-vjeçar në UT.
- c. Diplomë universitare “Master i Shkencave” në Degët e Inxhinierisë pranë UPT-së si dhe në Shkencat e Natyrës pranë Universitetit të Tiranës.
- d. Master i Shkencave ose DND të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit, në fusha të ngjashme.
- e. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të ekuivalentohen përpara aplikimit, sipas akteve ligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- f. Mesatare të ponderuar të notave në ciklin e parë të studimeve (diploma Bachelor/DNP) dhe në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave/DND, të programeve të integruara të nivelit të dytë dhe të sistemit të vjetër 5-vjeçar, jo më të vogël se 8 (tetë), ose jo më pak se 80 % e pikëve totale.



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE

- g. Njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja si: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin e miratuar nga SAUPT, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
- h. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e përmendura më sipër, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj.

Për kandidatët të cilët vijnë nga fusha të ndryshme jo të ngjashme me profilet e Inxhinierisë Matematike mund t'i nënshtrohen provimeve pranuese dhe/ose intervistave.

Neni 10

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FIMIF dhe UPT. Kandidatët regjistrohen sipas procedurave të miratuara nga FIMIF.

Neni 11

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- a. Kandidatët aplikojnë për t'u regjistruar në studimet e doktoratës me dosje individuale, ku të përfshihet fusha e studimit të doktoratës, që kërkon të ndjekë dhe drejtuesi shkencor;
- b. Deklaratë e drejtuesit shkencor për udhëheqjen e studimit të doktoratës, në fushën e përzgjedhur;
- c. Propozim për temën e kërkimit/metodologjinë/pritshmëritë, firmosur nga udhëheqësi;
- d. Letër motivimi;
- e. CV personale;
- f. Lista e punimeve shkencore të dokumentuara, nëse ka të tilla;
- g. Kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- h. Kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë "Master ekzekutiv", diplomë specializimi, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
- i. Fotokopje të kartës së indentitetit/pasaportës;
- j. Dy fotografi;
- k. Dy rekomandime nga persona me titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i asociuar", ku njëri prej të cilëve duhet të mbulojë fushën përkatëse të kërkimit shkencor;
- l. Vetëdeklarim ku kandidati pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të studimeve të doktoratës, sipas përcaktimeve të bëra nga UPT;
- m. Dëshmi të gjuhës së huaj, sipas kornizës ligjore në fuqi;
- n. Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar;



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE

o. Mandat pagese për tarifën e aplikimit

Neni 12

Përzgjedhja e kandidatëve për studimet e doktoratës:

1. Pranë DIM ngrihet komisioni “ad hoc” me tre deri pesë anëtarë, kryetar i të cilit është drejtuesi i projektit kërkimor fitues. Komisioni “ad hoc” propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore për miratim. Anëtarët e komisioni “ad hoc” janë anëtarë të njësisë bazë, që i përkasin kategorisë ‘Profesor’ ose në mungesë, të kategorisë “Lektor”, të cilët janë specialistë të fushës përkatëse të kërkimit ose fushave të përafërta.
2. Komisioni ad hoc duhet të mbledhet për të bërë vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve, mbështetur në dosjet e aplikimit, jo më vonë se dy javë pas mbylljes së aplikimeve. Komisioni ad hoc shpall renditjen paraprake të kandidatëve brenda 5 ditëve pune.
3. Lista me renditjen e kandidatëve dhe dosjet e tyre, i përcillen drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për miratim KP. KP shpall listën paraprake të kandidatëve fitues me drejtuesit shkencorë përkatës, brenda 5 ditëve pune.
4. Personeli akademik me kohë të plotë në Departamentin e Inxhinierisë Matematike i cili nuk zotëron gradën shkencore Doktor, do të ketë prioritet dhe do të regjistrohet automatikisht si një detyrim ligjor për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik në DIM.
5. Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit të kandidatëve, brenda tri ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues. Ankimimi bëhet pranë sekretarisë së njësisë kryesore.
6. KP-ja trajton ankimimet dhe i kthen përgjigje zyrtare në përputhje me procedurat administrative, brenda pesë ditëve pune. KP-ja shpall listën e përfundimtare të kandidatëve fitues.
7. Renditja përfundimtare e kandidatëve fitues publikohet në faqen zyrtare të njësisë kryesore përgjegjëse, si dhe në ambientet e saj.
8. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë e njësisë kryesore përgjegjëse për studimet e doktoratës, brenda dy javësh nga data e shpalljes së listës së kandidatëve fitues.
9. Në rast se një kandidat tërhiqet ose nuk regjistrohet brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai e humbet të drejtën e vazhdimin të studimeve të doktoratës dhe në vend të tij regjistrohet kandidati vijues në listën përfundimtare brenda një afati 5 ditë pune.
10. Dokumentacioni i aplikimit të kandidatëve fitues depozitohet në sekretarinë e njësisë kryesore dhe pasurohet gradualisht me të gjithë dokumentacionin që provon ecurinë e doktorantit.
11. Kandidatët fitues paguajnë tarifën për regjistrim në programin e studimit të doktoratës ku janë shpallur fitues. Kandidatëve jofitues iu kthehet dosja individuale me dokumentet e aplikimit, sipas kërkesës së tyre

IV. Zhvillimi i aktiviteteve

Neni 13

Studimet e doktoratës organizohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE

Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese, të cilat zhvillohen në bashkëpunim të studentit me udhëheqësin shkencor.

Studenti, në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor, prezanton planin e zhvillimit dhe metodologjinë e kërkimit, të cilat diskutohen dhe miratohen në njësinë bazë, ku studenti ndjek studimet e doktoratës. Plani i zhvillimit duhet të detajoj etapat e realizimit të kërkimit shkencor dhe realizimit të botimeve dhe referimeve shkencore.

Plani i punës përmban:

- a. Formimin e thelluar teorik që duhet të kryejë student;
- b. Kontributin në mësimdhënie pranë DIM ;
- c. Metodologjinë e kërkimit;
- d. Fazat e zhvillimit të kërkimit;
- e. Kontrollin e ecurisë së punës;
- f. Grafikon e zhvillimit të punës për çdo muaj ku specifikohet qartë se ku zhvillohet fizikisht secili proces i parashikuar.

Raportet e progresit përgatiten nga studentët e doktoratës, në bashkëpunim me udhëheqësin dhe shqyrtohen e miratohen çdo vit akademik në njësinë bazë përgjegjëse.

Puna kërkimore-shkencore duhet të paraqitet në formatin e një disertacioni. Disertacioni është pjesë e punës kërkimore-shkencore, me nivel të lartë akademik në lidhje me formulimin e argumenteve të kërkimit, bazën konceptuale, aspektet teorike, metodologjinë, dokumentimin dhe saktësinë e tij, përdorimin e literaturës dhe prezantimin e punës gjatë mbrojtjes para jurisë.

Disertacioni duhet të përfshijë kontribute origjinale në zhvillimin e njohurive të reja teorike/aplikative kundrejt disiplinës përkatëse dhe të ketë një standard akademik, i cili të justifikojë publikimin si pjesë e literaturës në fushën përkatëse. Kandidatët duhet të hartojnë disertacionin në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje të tij (2000- 4000 fjalë) në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, në format të shtypur dhe elektronik.

Kriteret bazë që duhet të plotësojë studentin përpara mbrojtjes së disertacionit jepen në aktet ligjore dhe nën-ligjore në fuqi në momentin e pranimit të studentit në programin e studimit.

Neni 14

Gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit i ciklit të tretë *Doktoratë* në “*Inxhinieri Matematike*”, është gjuha shqipe.

Neni 15

Formimi i thelluar teorik për Ciklin e Tretë të Studimeve *Doktoratë* në “*Inxhinieri Matematike*” do të zhvillohet në përputhje me rregulloren e Departamentit të Inxhinierisë Matematike, bazuar në rregulloren mësimore të FIMIF. Numri i krediteve i programit të studimit të doktoratës në Inxhinieri Matematike, mund të jetë deri në 30 kredite në varësi të projektit. Në cdo rast udhëheqësi shkencor përcakton lëndët dhe kreditet përkatëse që doktoranti duhet të plotësojë.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE

Plani mësimor i doktoratës

NR	Index	Lenda	Tipologjia e Lendës	ECTS				
				Kreditet gjithsej	Leksione	Ushtrime	Detyra /Projekt kursi	Laboratore
1.	MFM301	Programim kompjuterik dhe softje matematike	A	5	2.5	0	1	1.5
2.	MFM302	Metodologjia e kërkimit shkencor në Inxhinieri	A	5	3	1	1	0
3.	MFM303	Modelime inxhinierike dhe analizë numerike në ekuacionet diferenciale	B	10	5	2	0	3
4.	MFM304	Modele dhe metoda në ekuacionet diferenciale	B	5	3	1.5	0.5	0
5.	MFM305	Metoda të optimizimit numerik dhe kontrollit optimal.	B	5	2.5	1	0	1.5
6.	MFM306	Fuzzylogic dhe Rrjetat neurale artificiale ne Inxhinieri	B	5	3	0	1	1
7.	MFM307	Procese Stohastike	B	10	5	2	1	2
8.	MFM308	Teknika të avancuara të kërkimit operacional	B	5	3	1.5	0.5	0
9.	MFM309	Analiza Statistike shumë-përmasore	B	5	2.5	1	0	1.5
10.	MFM310	Sistemet e Informacionit Gjeografik	B	5	2.5	0	1	1.5

Neni 16

Dorëzimi i tezës dhe ngritja e jurisë:

- a. Dosja e studentit të doktoratës, së bashku me kopjet e përfunduara të disertacionit, të firmosura nga kandidati dhe udhëheqësi shkencor, dorëzohen pranë drejtuesit të njësisë



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE

- kryesore, së bashku me një kërkesë për fillimin e procedurës për fitimin e gradës shkencore “Doktor”.
- b. Drejtuesi i njësisë kryesore brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data e dorëzimit të dosjes, ia përcjell dosjen për vlerësim njësisë bazë. DIM brenda 30 (tridhjetë) ditëve jep vlerësimin dhe ia përcjell atë KP së FIMIF.
 - c. Në rast se njësia bazë jep vlerësim negativ për disertacionin/dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë dosjen e plotësuar me disertacionin pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj.
 - d. KP, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë me 5 anëtarë për vlerësimin e disertacionit, 2 (dy) nga të cilët, u përkasin DIM nga institucione homologe vendase ose të huaja. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, njëri prej të cilëve i përket DIM nga institucione homologe vendase ose të huaja.
 - e. KP, nëse e vlerëson negativisht dosjen (për mosrespektim të procedurave), e rikthen për plotësim pranë DIM.
 - f. Anëtarët e jurisë propozohen nga njësia bazë, me miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë). Anëtarët e jurisë duhet të jenë me titull “Profesor” ose “Profesor i asociuar”
 - g. Drejtuesi i njësisë kryesore i përcjell Rektorit të UPT-së jurinë e ngritur nga KP.
 - h. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj.
 - i. Kandidati duhet të pajisë çdo anëtar të jurisë me një kopje të disertacionit dhe mendimin e përgatitur nga udhëheqësi shkencor.
 - j. Njoftimi për datën dhe vendin e mbrojtjes së disertacionit bëhet publik nga FIMIF.

Neni 17

Mbrojtja e disertacionit të doktoratës bëhet në përputhje me Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në UPT në fuqi në momentin e pranimit të studentit në ciklin e tretë të studimeve.

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT

Prof. Dr. Luela PRIFTI